



ANTIRUST PROFESSIONAL



PAKETIMI

0.75L / 3.75 L



KOHA E THARJES

2-4 Orë



KONSUMI

10-12 m²/l

Përshkrim

ANTIRUST PROFFESIONAL është një suspension bojatisës profesional me cilësi të lartë me bazë rezinë alkide, me destinacion lysterjen e konstruksioneve metalike për tu mbrojtur nga ndryshku dhe për dekoracion. Referuar përbërësve të saj, ka vetinë që të frenojë procesin e oksidimit (ndryshkjes) të sipërfaqeve metalike, në mjedise të brendshme dhe të jashtme.

Fushat e Përdorimit:

ANTIRUST PROFFESIONAL përdoret për dozën e parë të lysterjes së sipërfaqeve metalike, në mjedise të brendshme dhe të jashtme, për mbrojtjen nga ndryshku të këtyre sipërfaqeve.

Parapërgatitja: Sipërfaqja që do të bojatiset, duhet të pastrohet nga pluhurat, yndyrnat apo nga shtresa të mëparshme të bojës apo të ndryshkut, të lidhura dobët me sipërfaqet.

Përdorimit: Përgatitet boja duke e holluar fillimisht me diluent NC – 10.00 ose NX – 20. 000 ose White Spirit “NEON” NW – 13.30 në sasi 10 % ÷ 20 %, për të përfutur një bojë të gatshme e cila të punohet relativisht lehtë me penel, rrul ose pistoletë dhe të mos rrjedhë në sipërfaqet vertikale.

Paketim

Paketimi bëhet në kuti metalike 0.75 dhe 3.75 L.

Kujdes: Nuk lejohet aplikimi i bojës në sipërfaqe të njoma dhe të pa pastruara paraprakisht. Gjatë aplikimit të përdoren doreza të përshtatshme pune për të evituar kontaktin e bojës me lëkurën, si dhe në rastin e përdorimit të pistoletës duhet përdorur maskë mbrojtëse për organet e frymëmarrjes. Në rast kontakti me sytë, duhet bërë shpërlarja e tyre me ujë të bollshëm dhe të kërkohet ndihmë mjekesore. Nuk rekomandohet përdorimi i bojës në temperaturë më të vogël se 50C. Pas përfundimit të lysterjes pajisjet duhet të lahen menjëherë me white spirit.



SKEDA TEKNIKE

Forma	E lëshshme
Ngjyra	Sipas katalogut
Magazinimi	12 muaj nëse ruhet në paketimin origjinal të mbyllur, në një vend të thatë
Imtësia	5 – 40 μm
Viskoziteti Deep Cup 4	200 – 300 sek
Densiteti	0.94 – 1.35 g/ml
Fuqia mbuluese për lyerje të plotë	10 – 12 m ² /L
Koha e tharjes	2 – 4 orë
Substanca të rrezikshme	Shiko SDS